



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 817 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

VENDIM

Nr. 272, datë 17.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Ndërtim çatie rrasë guri në banesën e Z. Vektor dhe Luljeta Memushi në lagjen Palorto”, Gjirokastër, me autor person i licencuar në restaurim Ark. Jorgo Xuhano;
 - Të plotësohet projekti me detaje teknike;
 - Të plotësohet projekti me foto të qarta;
 - Të pasqyrohen saktë ndërhyrjet;
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

